



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

<b>DATË /A</b>	<b>07.09.2017</b>
<b>REFERENCË</b>	
<b>PËR:</b>	<b>z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan</b>
<b>CC:</b>	<b>z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan</b>
<b>NGA:</b>	<b>z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan</b>
<b>LËNDA:</b>	<b>Raport i punës – Muaji Gusht 01.08.2017-31.08.2017</b>

Muaji Gusht për Drejtorinë Komunale të Arsimit në Lipjan ka qenë muaj i përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2017-2018. Përgatitja teknike – administrative dhe higjieno-sanitare e shkollave, përgatitja e kërkesave për libra të rinjë, ditarë, fletore pune, fletore aktive dhe materiale të ndryshme shkollore pa të cilat nuk mund të filloj procesi edukativo-arsimor. Përgatitja e kërkesave për lëndë djegëse: dru, thëngjill etj. Po ashtu janë realizuar punë dhe detyra të ndryshme:

Përfundimi i procedurave për rekrutimin e kuadrit të ri arsimor.

Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-dhjetë në Gjimnaze dhe shkolla Profesionale më date **21.08.2016**.

Mbajtja e testit të maturës afati i gushtit, pjesa e parë më datë **25.08.2017** dhe pjesa e dytë **30.08.2017**, test të cilit i'u nënshtruan **155** maturantë.

Ka filluar ndërtimi i shkollës së re në Rubovc.

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurave për furnizim me inventar për nevoja të çerdhës, dhe mallra të tjera të ndryshme.

Kerkesë KEDS-it për zhvendosjen e shtyllave të rrymës elektrike nga oborri i shkollës dhe vendosja e shtyllave të betonit jashtë oborrit të shkollës në Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan dhe intervenim emergjent – evitimin e defekteve në rrjetin elektrik në Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure, p.n.f në në Vershefc.

Nënalokimi në kategorinë: paga dhe zotimi i mjeteve në kategorinë: mallra&shërbime dhe komunal.

#### **Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:**

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirrollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).